

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr. Prokurimi: **KEK -21-7856-5-2-1**

Nr. I brendshëm: **KEKO 21 346 521**

Sa i përket tenderit:

“Projekti për rregullimin komplet të automatikës për servomekanizmat e ventilatorëve shtytës dhe flagrat shpejtë mbyllëse në bllokun A5.”

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**B&D Engineering SH.P.K.**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)  
Lidhja e Pejes nr.69

(Adresa)  
Prishtinë

10 000

(Vendi)  
+383 45 400 002

(Kodi postar)

(Numri Telefonit)  
Albana Zeqiraj

(Numri i Faks-it)

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

[b\\_dengineering@yahoo.com](mailto:b_dengineering@yahoo.com)

(Adresa elektronike)

02.12.2021

(Data e parashtrimt të ankesës)

  
(Nënshkrimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimt të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:*

26.10.2021 .....	Njoftimi për kontrate
09.11.2021 .....	”B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimit e publikuara”
12.11.2021 .....	”346 – Pyetje dhe Përgjigje”
15.11.2021 .....	”B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimit e publikuara”
17.11.2021 .....	”B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimit e publikuara”
22.11.2021 .....	Përgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim
23.11.2021.....	”B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimit e publikuara”

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po**

☐

**Jo**

☒

----------------------

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☐

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

*Ne respektim te te drejtes qe parasheh Ligji i Prokurimit publik, Operatori ekonomik "B&D Engineering SH.P.K." ne date 18.11.2021 i eshte drejtuar Autoritetit Kontraktor KEK sh.a me Kerkese per Rishqyrtim, duke i parashtruar faktet dhe argumentat per te cilat i kemi kerkuar A.K qe te merren ne konsiderate.  
(nje kopje e kesaj Kerkese per Rishqyrtim i bashkengjitet kesaj ankese ne listen e shtojcave).*

*Por ne date 22.11.2021 Autoriteti Kontraktor na kthen pergjigje duke e argumentuar Kerkesen tone per rishqyrtim si te pabazuar, ndaj dhe e refuzon ate.  
(nje kopje e pergjigjes se A.K i bashkengjitet kesaj ankese ne listen e shtojcave).*

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Ligji i Prokurimit Publik (Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92 i datës 21 Janar 2016) dhe rregullave të prokurimit të nxjerra në përputhshmëri me të.**

**Neni 1, Qellimi**

**Neni 7, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**

**Neni 27, Dosja e Tenderit**

**Neni 28, Specifikimet teknike**

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton*

që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejtshme ose mashtruese.

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Permes sistemit te prokurimit publik ne date 26.10.2021 jemi njohur me proceduren tenderike te sipercituar.

Si pale e interesuar ne kete procedure tenderike, kemi analizuar me shume kujdes kushtet e pjesemarrjes ne kete procedure prokurimi si edhe specifikimet teknike te detyrueshme.

Bazuar ne njohurite tona si rezultat i eksperiences shume-vjecare ne kete lami te industrise, pasi kemi analizuar kete Dosje tenderike dhe kemi konstatuar nje mosperputhje mes Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale/ Kapaciteti teknik dhe profesional te kerkuar nga A.K nga njera ane dhe parametrave, specifikave dhe sherbimeve & puneve te parapara per t'u realizuar nga O.E ne kete procedure.

Per kete arsye i jemi drejtuar A.K me nje Kerkese per Rishqyrtim duke i parashtruar argumentat tona.

Ne date 16.11.2021 A.K permes sistemit te E-prokurimit publikon nje sqarim mbi kapacitetin teknik dhe profesional qe do duhet te permbushë O.E ne kete tender  
Permes dokumentint “346 Pyetjet dhe Pergjigjet 3” A.K ben me dije:

***Operatori ekonomik ne ofertën e vet duhet te prezantoj stafin i cili do ti realizoj projektin sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues. Me hollësisht nga operatori ekonomik kërkohet qe ne ofertën e tij ta prezantoj:***

***Se paku një inxhinier te diplomuar ose bachelor te lemive: elektronike, automatike dhe te ketë përvojë ne Matje –rregullim komandim, programim, vizualizim si dhe te jete punëtor i rregullt i kompanisë, te dëshmohet me CV dhe kontrate pune, inxhinieri gjithashtu duhet te ketë trajnime për pajisjet :S7 300, Simatic dhe WinCC dhe këtë ta dëshmoj me ane te certifikatës.***

***Korrigjimi do te behet edhe përmes formularit standarde për përmirësimin e gabimeve ne platformën elektronike E-Prokurimi.***

Ky sqarim reflektohet edhe ne dokumentin “B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara” publikuar nga AK ne date 17.11.2021

Bazuar ne sa me siper, ne i jemi drejtuar A.K me Kerkese per rishqyrtim duke arsyetuar si me poshte:

**Ne e konsiderojme te pabazuar ne Ligj percaktimin e kerkesave mbi mundesine teknike dhe profesionale te kesaj procedure dhe vleresojme se keto kerkesa te percaktuara nga A.K nuk lidhen aspak me fusheveprimin e kesaj dosje tenderi dhe/ apo puneve te percaktuara nga A.K per t'u permbushur ne kuader te kesaj lende.**

**Specifikisht, duke kerkuar dorezimin e dokumentacionit perkates te se paku një inxhinieri te diplomuar ose bachelor te lemive: elektronike, automatike dhe te ketë përvojë ne Matje –rregullim komandim, programim, vizualizim si dhe te jete punëtor i rregullt i kompanisë, e dëshmuar kjo me CV dhe kontrate pune, inxhinier ky i cili gjithashtu do duhet te ketë trajnime për pajisjet :S7 300, Simatic dhe WinCC e vertetuar kjo me ane te certifikatës, jo vetem qe eshte nje kriter kufizues dhe penalizues per lejimin e pjesemarrjes te kompanive te ndryshme ne kete procedure, por njekohesisht e orienton tregun drejt nje prodhuesi eksplisit, duke thyer keshtu haptazi Ligjin e Prokurimit publik dhe duke cenuar njekohesisht konkurrencen e lire ne treg.**

Nese behet analiza teknike e “ANEKSI 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME” konstatohet se objekti i puneve te kesaj procedure lidhet drejtperdrejt me zvendesimin e sistemeve te vjetra ekzistuese me me sisteme të reja në teknikën e PLC-ve.

**SJELLIM NE VEMENDJE: Ky projekt mund te realizohet me se miri ne terma teknike edhe nga operatore ekonomike te cilet jo detyrimisht kane pjese te ekipit te tyre te inxhinierëve nje specialist te trajnuar për pajisjet S7 300, Simatic dhe WinCC sikurse KEK kerkon dhe mbi te gjitha JO DETYRIMISHT CDO OPERATOR EKONOMIK DO DUHET TE OFROJE ZGJIDHJE TEKNIKE SIPAS NJE PRODHUESI EKSPLICIT, NE RASTIN KONKRET “SIEMENS”. Nje zgjidhje shume e mire teknike mund t ‘i ofrohet A.K edhe permes nje teknologjie tjeter, permes nje propozimi teknik i cili nuk kerkon domosdoshmerisht perfshirjen e sistemit “Siemens”per te garantuar realizimin e ketij projekti.**

Sa me siper kemi konstatuar se me vendosjen e nje kriteri te tille teknik-profesional, A.K e ka orientuar tregun drejt nje prodhuesi specifik, duke shkelur keshtu Ligjin i Prokurimit Publik, Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi i cili shprehimisht parasheh:

#### **Neni 7**

*Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi*

- 1.Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*
- 2.Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.*
- 3.Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohej që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.*
- 4.Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.*
- 5.Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë,*

ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkesë të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.

6.Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

**Duke patur ne konsiderate faktin se projekti ne vetvete nuk parasheh aspak ofrimin e teknologjise qe lidhet specifikisht me pajisjet S7 300 (te cilat jane njekohesisht edhe te vjeteruara dhe qe jane zvendesuar me teknologji shume me te avacuar ne ditet e sotme) per cfare arsye A.K percakton si kriter kualifikues mbi kapacitetin teknik dhe profesional te nje kompanie dorezimin dokumentacionit te nje specialisti i cili specifikisht do duhet te kete nje certifikate trajnimi për pajisjet S7 300, Simatic dhe WinCC??**

Per kete arsye ne date 18.11.2021 kompania jone i eshte drejtuar A.K me kerkesat si me poshte vijon:

Largimin e kushtit te vendosur nga AK per se paku një inxhinier te diplomuar ose bachelor te lemive: elektronike, automatike dhe te ketë përvojë ne Matje –rregullim komandim, programim, vizualizim si dhe te jete punëtor i rregullt i kompanisë, te dëshmohet me CV dhe kontrate pune, inxhinieri gjithashtu duhet te ketë trajnime për pajisjet :S7 300, Simatic dhe WinCC dhe këtë ta dëshmoj me ane te certifikatës, publikuar ne date 17.11.2021

Por, ne pergjigje te kesaj kerkesë per rishqyrtim, ne date 22.11.2021, permes sistemit elektronik ne kemi pranuar nga A.K pergjigjen me shqyrtimin e ankeses te parashtruar, ku A.K ben me dije vendimin:

**(citat)**

Refuzohet si e pabazuar kerkesa e paraqitur per rishqyrtim nga O.E B&d Engineering sh.p.k, lidhur me “Projekti për rregullimin komplet te automatikes për servomekanizmat e ventilatorëve shtytës dhe flagrat shpejtë mbyllëse ne bllokun A5”me nr. Prokurimit KEKO 21 346 521.

Konform nenit 108/A te ligjit Nr. 04/L-042 per Prokurimin Publik te Republikes se Kosoves, i ndryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, pas ekzaminimit te Dosjes se tenderit dhe shqyrtimit te rrjedhjes se procedures se

*tenderimit, komisioni profesional vleresues i Autoritetit Kontraktues ne baze te kerkeses per rishqyrtim te Operatorit Ekonomik sqaron me sa vijon:*

*Pretendimet e OE jane te pa bazuara pasi qe:*

- 1. Kerkesa jone qe OE te kete staf profesional dhe te trajnuar per projekte te caktuara ne Matje, rregullim dhe Komandim nuk eshte jo ligjore dhe nuk e kufizon konkurencen.*
- 2. Per vemendjen tuaj paisjet qe jane te montuara nga fillimi i punes se bllokut A5 jane Simatic ne projektin e kerkuar.*
- 3. Ne jemi te vetedijshem qe ka paisje edhe me te avancuara se sa keto qe i kemi kerkuar, por ne do ti pranojme paisjet dhe stafin i cili eshte i trajnuar me sisteme dhe paisje me te avancuara.*
- 4. Njeherit edhe ne projekte te tjera te realizuara der me tani e kemi pasur te njejten kerkese teknike per staf te kualifikuar dhe trajnuar nga O.E dhe cdo here kemi pranuar me shume se nje OE konkurues.*
- 5. Ne qofte se largohet ky kriter sipas kerkeses suaj, atehere kerkesa jone nuk ka kuptim me kerku nga OE qe te realizoj projektin sepse po te kishim staf te mjaftueshem dhe te trajnuar ne do ta kishim realizuar vet, dhe nuk do te kishim kerkuar te realizohet nepermes tenderit.*

Ky vendim i A.K ne vleresimin tone eshte jo i sakte dhe jo ligjerisht jo i drejte, ndaj dhe po i drejtohem institucionit tuaj me kete Ankese.

Vini re ju lutem:

**Se pari:**

Sikurse i kemi bere me dije Autoritetit Kontraktor ne kerkesen per rishqyrtim, percaktimi i kshteve te pjesemarrjes ne kete procedure tenderike nuk eshte aspak ne harmoni apo ne perputhje me punet/ sherbimet/ mllrat objekt prokurimi ne kete lende.

Eshte shume e vertete se kerkesat e A.K qe OE te kene pjese te stafit te tyre specialiste profesionale dhe te trajnuar per projekte te caktuara ne matje, rregullim dhe komandim nuk eshte jo ligjore dhe nuk e kufizon konkurencen, POR nese A.K specifikisht percakton se specialistet do duhet te kene certifikata dhe apo trajnime eksplicite nga nje brand/ prodhues i vecante, kjo patjeter qe eshte kufizuese dhe e cenon konkurencen e lire ne treg dhe madje e orienton O.E drejt nje prodhuesi te vecante. Ndaj dhe ne e gjykojme jo ligjore percaktimin e nje kriteri te tille kulaifikues. Per kete arsye vleresojme se kjo eshte shkelja e pare qe A.K ka bere gjate perpilimit te kesaj dosje.

**Se dyti:**

Kemi konstatuar se A.K ka bere edhe nje shkelje tjeter ne kete DST.

Gjate site vizites se mbajtur per kete procedure ne date 03.11.2021, operatoreve ekonomike pjesemarres u eshte bere me dije nga ekipi i specialisteve ne sajt se Autoriteti Kontraktor do duhet te beje nje ndryshim ne ANKESI 1 Specifikimet teknike te detyrueshme dhe po ashtu edhe ne dokumentin “Pershkrimi i cmimeve”kjo, pasi qe disa pozicione do duhet te hiqen nga lista e produkteve te kerkuara per kete dosje tenderike.

Por fakt eshte qe deri me tani ne asnje moment KEK nuk ka dale me nje formular korrigjimi te gabimeve dhe apo sqarime shtese ku te beje me dije nje njoftim te tille te komunikuar nga ekspertet e A.K ne sajt vizite.

Me konkretisht, specialistet e KEK gjate site vizites i kane kumunikuar operatoreve ekonomike pjesemarres se:

Ne Dosjen e tenderit ne ANEKSI 1 SPECIFIKIME TEKNIKE TE DETYRUESHME, po ashtu edhe ne dokumentin “Pershkrimi i cmimeve” Autoriteti kontraktor do duhet qe te heqe nga kerkesa per kete procedure zerat si me poshte vijon:

3.	Ngasja e Ventillatorit thithës në kanalin A	copë	1
4.	Ngasja e Ventillatorit thithës në kanalin B	copë	1
5.	Ngasja e Ventillatorit thithës në kanalin C	copë	1

9.	Ngasja e Ventillatorit shtytës në kanalin A	copë	1
10.	Ngasja e Ventillatorit shtytës në kanalin B	copë	1
11.	Ngasja e Ventillatorit shtytës në kanalin C	copë	1

15.	Ngasja e flegres shpejtëmbyllse për Ventillatorin në kanalin A	copë	1
16.	Ngasja e flegrës shpejtëmbyllse për Ventillatorin në kanalin B	copë	1
17.	Ngasja e flegres shpejtëmbyllse për Ventillatorin në kanalin C	copë	1

Por, pavarsisht kesaj, Autoriteti Kontraktor ne asnje moment nuk na ka njoftuar me shkrim per kete ndryshim qe eshte dashur te reflektohet ne listen e produkteve/ sherbimeve te kerkuara per kete DST.

Sa me sipër duke vlerësuar qe nje fakt i tille na konfuzion dhe e ben te paqarte saktesisht objektin e kesaj procedure prokurimi, gykojme se A.K ka vepruar ne shkelje te plote te LPP, Neni 1, Qellimi & Neni 28, Specifikimet teknike duke mos bere me dije saktesisht objektin e kesaj procedure dhe se cilat do duhet te jene specifikimet teknike qe do duhet te merren ne konsiderate ne baze te te cilave do duhet te perpilohet oferta tekniko-financiare per kete procedure tenderike.

Sa me sipër, duke i parashtuar institucionit tuaj keto argumenta dhe fakte, shpresojme qe Ankesa jone do merret ne konsiderate dhe AK do beje rregullimet e nevojshme ne kete procedure tenderike.



## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

n/a
-----

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) Dëshmia ë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se,*
- b) Njoftimi per kontrate*
- c) DST*
- d) 346- Pyetjet dhe Pergjigjet-3*
- e) B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 1, (2) (3)*
- f) Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar)*
- g) Kerkese per rishqyrtim B&D Engineering*
- h) Vendimi i A.K- se, pergjigje ndaj KPR “B&D Engineering”*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*